



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Për

Miratimin e bursave dhe gjysëm bursave të studimeve , për studentët e vitit të parë , për vitin shkollor 2011 - 2012 .

Nr. 12 Datë 02.03.2012

Për miratimin e bursave dhe gjysëm bursave të studimit , për studentët e vitit të parë , për vitin shkollor 2011 – 2012 , mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 526 dt 20.07.2011 për “ Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte , bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe te studentëve , në institucionet arsimore publike , për vitin shkollor 2011 – 2012 ” , si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 , neni 8 pika II/A dhe II/C “ Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore “ , neni 32 , pika k ;

Keshilli i Bashkisë së Qytetit Korçë , në mbledhjen e tij të dates se sotme , pasi mori në shqyrtim relacionin nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes “ Për miratimin e bursave dhe gjysëm bursave të studimeve , për nxënësit dhe studentët e vitit të parë , për vitin shkollor 2011 - 2012 :

VENDOSI

Të miratojë gjysëm bursë , pasi i plotësojnë të gjitha kushtet për vitin shkollor 2011 -2012 studentëve të mëposhtëm :

- **Liria Roland Zaçe** , studente në vitin e parë në Universitetin e Tiranës , Fakulteti i Gjuhëve të Huaja , Dega Gjuhë Frënge .
- **Klodian Dhimitraq Gaçe** , student në vitin e parë Universitetit të Tiranës , Fakulteti i Mjekësisë , Dega Mjekësi e Përgjithëshme.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Ilirjan PENDAVINJI